



**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 01, Datë 10.01.2020

MBI

**PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN DHJETOR 2019.**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 87 pika 4, të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar; “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s Nr. 201, datë 04.12.2017, i ndryshuar; nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s Nr. 96, datë 03.09.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 10.01.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 314 Prot, datë 09. 01. 2020, për gatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit” për muajin Dhjetor 2019,

Konstatohet se:

- OSHEE sh.a, me shkresën nr. 25963 Prot., datë 27.12.2019, protokolluar në ERE me nr. 109/ 21 Prot, datë 30.12.2019, paraqiti aplikimin për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin Dhjetor 2019.
- Gjatë analizës së informacionit të paraqitur në këtë aplikim u evidentuan disa paqartësi dhe mangësi në lidhje me llogaritjen e çmimit të blerjes së energjisë elektrike dhe kursin e këmbimit të cilën shoqëria ka përdorur, këto konstatime i'u bënë me dije OSHEE sh.a. nëpërmjet komunikimit në adresën zyrtare elektornike të shoqërisë.
- Shoqëria “OSHEE” sh.a. me shkresën nr. 75 Prot., datë 08.01.2020 paraqiti aplikimin e saktësuar në të cilin ka llogaritur çmimin e shitjes së energjisë elektrike për klientët e FMF-së për muajin Dhjetor 2019 në vlerën 16.57 Lekë/kWh.
- Llogaritjet e OSHEE sh.a., si dhe propozimi i ERE-s për përcaktimin e çmimit për klientët që furnizohen nga FMF për muajin Dhjetor 2019 sipas “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të

shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit” të rishikuar paraqiten në tabelën përmbledhëse si vijon:

Çmimi i FMF-së për muajin Dhjetor 2019

Dhjetor 2019		Njësia	Aplikimi	Propozimi i
			OSHEE Sh.a	ERE
a	Çmimi maksimal i blerjes në treg të parregulluar ose blerja nga prodhuesit me përparësi	Leke/kWh	12.161	12.161
b	Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Leke/kWh	0.36	0.36
c	Çmimi maksimal i blerjes në periudhën relevante	Leke/kWh	12.53	12.53
d	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Leke/kWh	1.79	1.79
e	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Leke/kWh	0.75	0.75
f	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Leke/kWh	1.50	1.50
Çmimi i energjisë (c+d+e+f)		Leke/kWh	16.57	16.57

- Duke u bazuar në informacionin e aplikimit të muajit Dhjetor 2019 që shoqëria OSHEE sh.a. ka paraqitur në ERE, raportimeve periodike mujore për blerjen e energjisë elektrike në tregun e parregulluar, si dhe nga kontrolli i platformës online ku shoqëria publikon informacionin e detajuar mbi realizimin e procedurave të blerjes së energjisë elektrike rezulton se, për këtë muaj nuk është zhvilluar asnjë procedurë për blerjen e energjisë nga tregu i parregulluar. Në vijim, shoqëria shprehet se në zbatim të metodologjisë për çmimin maksimal të blerjes së energjisë për këtë muaj i është refuar çmimit të energjisë nga prodhuesit me përparësi i cili është 0.1 €/kWh .
- Shoqëria “OSHEE” sh.a. deklaroi se, për llogaritjen e çmimit të blerjes së energjisë elektrike ka përdorur kursin zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të datës 26.12.2019, kjo për arsye të afateve kohore të mbylljes së ciklit të faturimit për muajin Dhjetor 2019 për klientët FMF, meqënëse gjatë këtij muaji nuk ka patur blerje energjie në treg të parregulluar për këta klientë.
- Duke iu referuar kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë prej 121.61 Lekë/ Euro që shoqëria ka konsideruar në këtë aplikim, çmimi i blerjes së energjisë elektrike nga tregu i parregulluar rezultoi të jetë 12,161 Lekë/kWh.
- **Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit:** bazuar në Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 266, datë 21.12.2018 “Mbi përcaktimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike nga shoqëria “OST” sh.a. për vitin 2019” është 0.75 lekë/kWh.
- **Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 35 kV:** bazuar në Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 268, datë 21.12.2018 “Mbi lënien në fuqi të Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 190 datë 30.8.2018 në lidhje me tarifën e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes sipas nivelit të tensionit

dhe çmimet me pakicë për për klientët fundorë që shërbehen nga furnizuesi i shërbimit universal për vitin 2019” është 1.5 Lekë/kWh.

- Për sa përcaktuar për çdo element të formulës përlllogaritëse rezulton që çmimi i shitjes nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin Dhjetor 2019 të jetë 16.57 Lekë/kWh.

Për gjithë sa më sipër cituar bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Miratimin e çmimit të furnizimit me energji elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit prej 16.57 Lekë/kWh, për muajin Dhjetor 2019.
2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE

Petrit AHMETI